# "Investment Joti-Infosoft Group" sh.p.k.

## Pasqyra Financiare individuale
## (Per periudhen 1 Janar -31 Dhjetor 2015)
## ( ne Leke)

PERMBAJTJA


| Emertimi | Faqe |
|---|---|
| Raporti i audituesit te pavarur | 1-2 |
| Pasqyra e pozicionit financiar | 3 |
| Pasqyra e Performances | 4 |
| Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare | 5 |
| Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin neto | 6-14 |
| Shenime per pasqyrat financiare | |

# RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUAR

**Drejtuar: Ortakëve të shoqërisë "ITD" shpk,**
**Rruga "Murat Toptani", "Gjergji Center"**
**Tiranë**

**Të nderuar,**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë "ITD" sh.p.k., të cilat perfshijne pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 Dhjetor 2015, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare, për vitin ushtrimor të përfunduar në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues.

**Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë edhe për shkak të mashtrimit apo gabimit.

**Përgjegjësia e audituesit**

Përgjegjësia jonë, është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare, bazuar në procedurat e auditimit. Ne e kemi kryer auditimin, në perputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin, nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencen e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna ne pasqyrat financiare.Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezIqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë per shkak të mashtrimit apo gabimit.
Gjatë kryerjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave përkatëse të entitetit, por jo për qellime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit te brendshëm të tij.
Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmerisë së politikave kontabël të përdorura dhe të aryetueshmërisë së çmuarjeve kontabël të kryera nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithëshme të pasqyrave financiare.
Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

**Opinion**

**Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të shoqërisë "ITD" sh.p.k. me datë 31 Dhjetor 2015, performancës së saj financiare dhe flukset e parasë, për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë, në përputhje me Ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar, si dhe parimet bazë e rregullat e parashikuara në "Standartet Kontabël Kombëtare".**

**Çështje të tjera**
Pasqyrat financiare te vitit 2014 jane audituar nga nje auditues tjeter, i cili ka shprehur nje opinion te pamodifikuar per to.

**Venis-Audit & Financë sh.p.k.**

**Vera Lala**
**Ekspert Kontabël i Regjistruar**

Tiranë, më 22 Mars 2016

"VENIS-Audit & Financë" sh.p.k.
E.K.R.
Liçensë nr.238
Tiranë

**Investment Joti -Infosoft Group shpk**

## Pasqyra e Pozicionit Financiar

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2015

| Nr | A K T I V E T | Shenime | 31.12.2015 | 31.12.2014 |
|---|---|---|---|---|
| | **Aktivet Afatshkurtra** | | | |
| | ▶ **Aktivet monetare** | | **247,523,858** | **139,530,966** |
| | 1 *Banka* | 1 | 247,523,858 | 139,530,966 |
| | 2 *Arka* | | 0 | 0 |
| | ▶ **Investime** | | | |
| | | | | |
| | ▶ **Të drejta të arkëtueshme** | | **30,631,463** | **3,561,312** |
| | 1 *Nga aktiviteti i shfrytëzimit* | | | |
| | 2 *Nga njësitë ekonomike brenda grupit* | 2 | 27,632,527 | 0 |
| | 3 *Nga njësitë ekonomike ku ka intereso pjesëmarrëse* | | | |
| | 4 *Të tjera* | 3 | 2,998,936 | 3,561,312 |
| | 5 *Kapital i nënshkruar i papaguar* | | | |
| | | | | |
| | ▶ **Inventarët** | 4 | 0 | **192,516** |
| | 1 *Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme* | | 0 | 192,516 |
| | 2 *Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte* | | | |
| | 3 *Produkte të gatshme* | | | |
| | 4 *Mallra* | | | |
| | 5 *Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)* | | | |
| | 6 *AAGJM të mbajtura për shitje* | | 0 | 0 |
| | 7 *Parapagime për inventar* | | | |
| | | | | |
| | ▶ **Shpenzime të shtyra** | | 0 | 0 |
| | ▶ **Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara** | | | |
| | | | | |
| I | TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA | | 278,155,321 | **143,284,794** |
| | **Aktivet Afatgjata** | | | |
| | ▶ **Aktive financiare** | | **1,715,298,285** | **1,995,723,101** |
| | 1 *Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit* | 5 | 821,464,394 | 800,815,792 |
| | 2 *Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit* | 6 | 893,833,891 | 1,194,907,309 |
| | | | | |
| | ▶ **Aktivet materiale** | 7 | **1,047,260,413** | **1,028,521,650** |
| | 1 *Toka dhe ndërtesa* | | 1,023,796,020 | 1,023,796,020 |
| | 2 *Impiante dhe makineri* | | 23,119,025 | 4,335,862 |
| | 3 *Të tjera instalime dhe pajisje* | | 345,368 | 389,768 |
| | 4 *Parapagime për aktive materiale dhe në proces* | | | |
| | | | | |
| | ▶ **Ativet biologjike** | | | |
| | | | | |
| | ▶ **Aktive jo materiale:** | | | |
| | 1 Koncesione,patenta,liçenca,marka tregtare,të drejta | | | |
| | 2 *Emri i Mirë* | | | |
| | 3 *Parapagime për AAJM* | | | |
| | | | | |
| | ▶ **Aktive tatimore të shtyra** | | 4,341 | 0 |
| | ▶ **Kapitali i nënshkruar i papaguar** | | | |
| | | | | |
| II | TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA | | 2,762,563,039 | **3,024,244,751** |
| | A K T I V E T O T A L E | | 3,040,718,359 | 3,167,529,545 |

Financier

Stravrulla Gabi

Administrator

Gridon Joti

**Investment Joti -Infosoft Group shpk**

## Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2015

| Nr | DETYRIMET DHE KAPITALI | Shenime | 31.12.2015 | 31.12.2014 |
|---|---|---|---|---|
| | ▶ **Detyrime afatshkurtra:** | | | |
| | 1 *Titujt e huamarrjes* | | 9,958,238 | **307,759** |
| | 2 *Detyrime ndaj institucioneve të kredisë* | | | |
| | 3 *Arkëtime në avancë për porosi* | | | |
| | 4 *Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit* | | 0 | 0 |
| | 5 *Dëftesa të pagueshme* | 8 | 0 | 56,612 |
| | 6 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit* | | | |
| | 7 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse* | | 0 | 0 |
| | 8 *Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shën* | | | |
| | 9 *Të pagueshme për detyrimet tatimore* | 9 | 402,179 | 101,138 |
| | 10 *Të pagueshme për detyrimet ndaj ortakut* | 10 | 9,556,059 | 150,009 |
| | ▶ **Të pagueshme për shpenzime të konstatuara** | | | |
| | ▶ **Të ardhura të shtyra** | 11 | **28,941** | **0** |
| | ▶ **Provizione** | 12 | 0 | **389,768** |
| | **Totali i Detyrimeve afatshkurtera** | | **9,987,179** | **697,527** |
| | ▶ **Detyrime afatgjata:** | | **2,365,346,878** | **2,936,786,909** |
| | 1 *Titujt e huamarrjes* | | | |
| | 2 *Detyrime ndaj institucioneve të kredisë* | | | |
| | 3 *Arkëtimet në avancë për porosi* | | | |
| | 4 *Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit* | | | |
| | 5 *Dëftesa të pagueshme* | | | |
| | 6 *Të pagueshme për detyrimet ndaj ortakut* | 13 | 2,365,346,878 | 2,936,786,909 |
| | ▶ **Të pagueshme për shpenzime të konstatuara** | | | |
| | ▶ **Të ardhura të shtyra** | | | |
| | ▶ **Provizione:** | | | |
| | 1 *Provizione për pensionet* | | | |
| | 2 *Provizione të tjera* | | | |
| | ▶ **Detyrime tatimore të shtyra** | | | |
| | | | | |
| | **Totali i Detyrimeve afatgjata** | | **2,365,346,878** | 2,936,786,909 |
| | **DETYRIMET TOTALE** | | **2,375,334,057** | **2,937,484,437** |
| | ▶ **Kapitali dhe Rezervat** | | | |
| | ▶ **Kapitali i Nënshkruar** | 14 | 222,687,000 | 222,687,000 |
| | ▶ **Primi i lidhur me kapitalin** | | | |
| | ▶ **Rezerva rivlerësimi** | | | |
| | ▶ **Rezerva të tjera** | | | |
| | 1 *Rezerva ligjore* | | | **32,779** |
| | 2 *Rezerva statutore* | | | |
| | 3 *Rezerva të tjera* | | | |
| | ▶ **Fitimi i shpërndarë** | | 0 | 32,779 |
| | ▶ **Fitim / Humbja e Vitit** | | | -380,000,000 |
| | | | 442,697,302 | 387,325,329 |
| | **Totali i Kapitalit** | | 665,384,302 | **230,045,108** |
| | | | | |
| | **TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT** | | **3,040,718,359** | **3,167,529,545** |

Financier

Stravrulla Gabi



Administrator

Grigor Joti

**Investment Joti -Infosoft Group shpk**

## Pasqyra e Performancës

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2015

| Nr | Pershkrimi i Elementeve | Shenime | Viti 2015 | Viti 2014 |
|---|---|---|---|---|
| ► | Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | 15 | **440,638,940** | **382,477,729** |
| ► | Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces | | | |
| ► | Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar | | | |
| ► | Të ardhura të tjera të shfrytëzimit | | | |
| | | | | |
| ► | Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme | | | |
| | *1 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme* | | | |
| | *2 Të tjera shpenzime* | | | |
| | | | | |
| ► | Shpenzime të personelit | | **-4,930,485** | **-13,829,646** |
| | *1 Paga dhe shpërblime* | | -4,534,430 | -13,035,130 |
| | *2 Shpenzime të sigurimeve shoq/shend (paraqitur veçmas nga shp për pensionet)* | | -396,055 | -794,516 |
| | *3 Te tjera personeli* | | | |
| ► | Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale | | | |
| ► | Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 7 | **-2,353,515** | **-1,390,307** |
| ► | Shpenzime të tjera shfrytëzimi | 16 | **-4,250,477** | **-3,767,821** |
| | | | | |
| ► | Të ardhura të tjera | | **51,862,860** | **23,837,901** |
| | 1 *Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)* | | | |
| | 2 *Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)* | | | |
| | 3 *Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)* | 17 | 48,327,559 | 42,099,354 |
| | 4 Te ardhura /shpenzime nga veprimet valutore, etj | 18 | 3,535,301 | -18,261,453 |
| ► | Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra | | **0** | **0** |
| | | | | |
| ► | Shpenzime financiare | | **-37,715,376** | **0** |
| | 1 *Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)* | 19 | -37,715,376 | 0 |
| | *2 Shpenzime të tjera financiare* | | | |
| ► | Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet | | **0** | 0 |
| ► | Fitimi/Humbja para tatimit | | **443,251,947** | **387,327,856** |
| ► | Shpenzimi i tatimit mbi fitimin | | -554,644 | **-2,527** |
| | *1 Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin* | 20 | -558,985 | -2,527 |
| | *2 Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë* | | 4,341 | |
| | *3 Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve* | | | |
| | | | | |
| ► | Fitimi/Humbja e vitit | | 442,697,302 | **387,325,329** |
| ► | Fitimi/Humbja për: | | **0** | **0** |
| | *Pronorët e njësisë ekonomike meme* | | | |
| | *Interesat jo-kontrolluese* | | | |

Financier

Stravruila Gabi

Administrator

[illegible] Joti

# Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare
## *(metoda direkte)*

| | Viti 2015 | Viti 2014 |
|---|---|---|
| ▶ **Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit** | | |
| *Të arkëtuara nga të drejtat e arkëtueshme* | 0 | |
| *Të paguara për detyrimet e paguashme dhe detyrimet ndaj punonjësve* | -7,911,326 | -14,218,582 |
| *Pagesa të tjera* | -8,223,483 | -42,228,642 |
| **Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti i shfrytëzimit** | **-16,134,809** | **-56,447,224** |
| *Interes i paguar* | 0 | |
| *Tatim fitimi i paguar* | 0 | |
| **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit** | **-16,134,809** | **-56,447,224** |
| ▶ **Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit** | | |
| *Para neto të përdorura për blerjen e filialeve* | | |
| *Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve* | | |
| *Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale* | -21,092,278 | |
| *Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale* | | 3,614,927 |
| *Pagesa për blerjen e investimeve të tjera* | | -125,910,288 |
| *Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera* | | |
| *Dividentë të arkëtuar* | 392,357,812 | 386,610,089 |
| **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit** | **371,265,534** | **264,314,728** |
| ▶ **Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit** | | |
| *Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar* | | |
| *Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral* | | |
| *Hua të arkëtuara* | 1,403,170,121 | 1,498,052,053 |
| *Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë* | | |
| *Riblerje e aksioneve te veta* | | |
| *Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral* | | |
| *Pagesa e huave* | -1,682,420,744 | -1,272,112,990 |
| *Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare* | | |
| *Interes i paguar* | 38,151,949 | 40,077,744 |
| *Dividendë të paguar* | -6,226,530 | -343,358,910 |
| **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit** | **-247,325,203** | **-77,342,103** |
| | | |
| **Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve mone** | **107,805,522** | **130,525,401** |
| **Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 Janar** | 139,530,966 | 8,951,926 |
| *Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare* | 187,370 | 53,639 |
| **Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor** | **247,523,858** | **139,530,966** |

0 0

INVESTMENT JOTI - InfoSoft Group

## Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

| | Kapitali i nënshkruar | Rezerva të tjera | Fitimet e Pashpërndara | Fitim / Humbja e vitit | Totali | Interesa Jo-Kontrollues | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2013 | 222,687,000 | 161,660 | 633,384 | 876,518 | 224,358,562 | | 224,358,562 |
| Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël | | | | | - | | - |
| Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2014 | 222,687,000 | 161,660 | 633,384 | 876,518 | 224,358,562 | | 224,358,562 |
| Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin: | | | | | | | |
| Fitimi / Humbja e vitit | | | | | - | | - |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse: | | - 128,881 | | 387,325,329 | 387,196,448 | | 387,196,448 |
| Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin: | | | | | - | | - |
| Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital: | | | | | - | | - |
| Emetimi i kapitalit të nënshkruar | | | | | - | | - |
| Zvogelimi i kapitalit aksioner | | | | | - | | - |
| Dividendë të paguar | | | | | - | | |
| Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike | | | -633,384 | -380,878,518 | - 381,509,902 | | - 381,509,902 |
| Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014 | 222,687,000 | 32,779 | - | 7,325,329 | 230,045,108 | | 230,045,108 |
| Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël | | | | | - | | - |
| Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015 | 222,687,000 | 32,779 | - | 7,325,329 | 230,045,108 | | 230,045,108 |
| Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin: | | | | | | | |
| Fitimi / Humbja e vitit | | | | | - | | - |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse: | | - 32,779 | | 442,697,302 | 442,664,523 | | 442,664,523 |
| Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin: | | | | | - | | - |
| Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt ne kapital: | | | | | - | | - |
| Emetimi i kapitalit të nënshkruar | | | | | - | | - |
| Dividendë të paguar | | | | | - | | - |
| Caktimi i fitimit te pashperndare | | | | - 7,325,329 | - 7,325,329 | | - 7,325,329 |
| Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike | | | | | - | | - |
| Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015 | 222,687,000 | - | - | 442,697,302 | 665,384,302 | - | 665,384,302 |

**SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE**
**per periudhen 1 Janar -31 Dhjetor 2014**
**( ne Leke)**

## 1. INFORMACIONE TE PERGJITHESHME

Shoqeria "Investment Joti" sh.p.k eshte themeluar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me date 17.02.2009 dhe eshte rregjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me date 25 Shkurt 2009, me numer unik te identifikimit K91425022E.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", nga statuti dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi per tatimet dhe taksat.

Objekti: Pjesemarrje ne shoqeri, veprimtari kreditimi ose huamarrje; blerje, shitje dhe mbajtje ne pronesi e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme ; Konsulence ne manaxhim biznesi;

Kapitali themeltar: 222,687,000 leke, i ndare ne 2 kuota.

Kuotat e pronesise: Z. Grigor Joti, zoterues i 1 kuote qe perben 80 % te kapitalit dhe Znj.Marjeta Joti zoteruese e 1 kuote qe perben 20% te kapitalit.

Administrator: Z. Grigor Joti, me te drejta dhe detyra te percaktuara ne statutin e shoqerise.

Adresa e selise :Rruga "Murat Toptani", "Gjergji Center" ne Tirane

Shoqeria kryen aktivitetin e saj ne ambjente qe jane te mara me qira.

Numri i punonjesve me date 31 Dhjetor 2015 ishte ndersa me 31 Dhjetor 2014 ishte 5 punonjes.

## II.PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL

### Bazat per pergatitjen e pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne te gjitha aspektet materiale, duke respektuar kerkesat e parashikuara ne Ligjin nr. 9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" te ndryshuar si dhe parimet baze e rregullat e parashikuara ne Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara (SKK).

Per zbatimin e politikave kontabel per vleresimet si dhe per te tjera elemente te nevojshem per pergatitjen e pasqyrave financiare (PF) te vitit 2015, jemi referuar tek SKK nr.1- "Kuadri i pergjithshem per pergatitjen e pasqyrave financiare". Politikat kontabël janë parimet specifike, bazat, konvencionet, rregullat dhe praktikat e zbatuara nga një njësi ekonomike në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. Pasi përzgjidhet një politikë kontabël, ajo zbatohet në mënyrë të qëndrueshme vit pas viti. Politika kontabël mund të ndryshojë ne raste specifike, te parashikuara ne SKK.

Lista e llogarive e perdorur per mbajtjen e regjistrimeve kontabel, eshte ajo e shpallur nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit.

Pasqyra e Pozicionit Financiar, Pasqyra e Performancës, Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare dhe Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto, jane paraqitur sipas formatit te parashikuar ne SKK-2 të përmirësuar. Informacioni per gjendjen me date 31.12.2015 eshte plotesisht i krahasueshem per cdo element te PF. Ne shenimet shpjeguese jane paraqitur vlerat analitike per cdonjerin prej tyre.

Sipas parimeve te kontabilitetit te pranuara gjeresisht ne Shqiperi, deklarimet financiare jane pergatitur mbi bazen e konceptit materialitetit, te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara, te parimit te vijimesise etj, sipas SKK 1.

**Bazat e përgatitjes**

Disa të dhëna financiare, të paraqitura në pasqyrat financiare, bazohen në vlerësime të bëra nga drejtuesit e njësisë ekonomike, dhe jo në fakte të vëzhguara në mënyrë objektive. Shembuj të zbatimit të vlerësimeve kontabël janë:
(a) vlerësimi i zhvlerësimeve për kërkesat e arkëtueshme dhe inventarëve;
(b) vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, si dhe përcaktimi i normave përkatëse të amortizimit;
(c) krijimi i provizioneve për shitjet me garanci ose për mbulimin e kostove që lidhen me procedurat gjyqësore në proces.
Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.
Vlerat ne pasqyrat financiare jane shprehur ne monedhen kombetare LEKE.

**Bazat e matjeve**

Në përgatitjen e pasqyrave financiare janë zbatuar perimet kontabël që njihen si më të përshtatshme për të matur dhe paraqitur gjendjen financiare, rezultatin financiar dhe flukset e parasë mbi gjendjen e kontabilitetit rrjedhës ( të drejtat dhe detyrimet e konstatuara). Matja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve që plotësojnë kriterin e njohjes, bëhet me koston historike, përveç rasteve kur SKK 1, kërkon matje fillestare mbi një bazë tjetër të tillë si vlera e drejtë. Vlerësimi i mëpasshëm i aktiveve dhe detyrimeve financiare behet me kosto të amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm, sikurse percaktohet ne SKK 3, ndersa te aktivet dhe pasivet e tjera duhet ti referohemi rast pas rasti SKK-ve perkatese.

**Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse (rritjen e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës raportuese, që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësimin e pasiveve, si dhe që rrisin kapitalin e njësisë ekonomike raportuese, duke përjashtuar këtu ato që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga njësia ekonomike për llogari të vet. Shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto. Për këtë arsye ato nuk përfshihen në të ardhura.
Të ardhurat përfshijnë vetëm vleren e drejte te përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe sherbimeve gjate aktivitetit te zakonshem te kompanise.

**Njohja e shpenzimeve**

Shpenzimet qe lidhen me te ardhurat e fituara gjate periudhes raportuese njihen ne te njejten periudhe kontabel si dhe te ardhurat perkatese. Shpenzimet e kryera gjate nje periudhe raportuese, qe ndryshon nga periudha kur ato i sjellin perfitime njesise ekononike raportuese, rregjistrohen si shpenzime pikerisht ne periudhen kur merren perfitimet. Shpenzimet e ndodhura, per te cilat njesia ekonomike nuk pret perfitime te ardhshme, njihen menjehere ne rezultatin financiar.

**Aktivet monetare**

Ne kete ze perfshihen mjetet monetare gjendje ne date 31.12.2015 ne llogarite rrjedhese prane bankave te nivelit te dyte si dhe ne arke. Per njohjen fillestare te ketyre elementeve si dhe per gjendjet, eshte perdorur politika kontabel e vleres nominale.

**Të drejta të arkëtueshme**

Ne kete ze jane perfshire Kerkesa te arketueshme nga klientet nga aktiviteti i shfrytëzimit, si dhe kerkesa te tjera debitore, te cilat jane vleresuar me kosto te amortizuar minus ndonje zhvleresim te mundshem (nese ka).

**Detyrime te pagueshme**

Ne kete grup jane perfshire detyrimet e pagueshme ndaj institucioneve te kredise, furnitoreve, punonjesve, ortakeve per dividente dhe hua, kreditoreve te tjere, etj. Ne njohjen fillestare zerat e ketij grupi jane vleresuar me kosto. Ne fund te vitit detyrimet vleresohen me kosto te amortizuar minus ndonje zhvleresim te mundshem.

INVESTMENT JOTI - InfoSoft Group

Parimisht, ne vijim te njohjes fillestare, huate dhe detyrimet e tjera paraqiten me kosto te amortizueshme duke njohur cdo diference midis kostos dhe vleres se rikuperueshme ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamarrjes ne baze te nje interesi efektiv.

**Detyrime tatimore**

Ne kete grup perfshihen te gjitha llojet e tatimeve e taksave, te llogaritura e te papaguara ndaj administrates tatimore, te cilat vleresohen me vlere nominale. Detyrimet tatimore afatshkurtra dhe afatgjata nuk skontohen dhe nuk zhvleresohen.

**Aktive afatgjata materiale (AAM)**

Ne bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi (nuk ka patur humbje nga zhvleresimi).

Ne kete grup jane paraqitur gjendjet e aktiveve afatgjata materiale qe perbehen nga mjete transporti,pajisje informatike mobilje e pajisje zyre. Aktivet Afatgjata Materiale jane vleresuar me koston e blerjes dhe kosto te tjera te drejtperdrejta qe lidhen me sjelljen e aktivit ne kushtet e nevojshme per funksionimin e tij.

Metoda per llogaritjen e amortizimit per te gjitha AAM e shoqerise, eshte metoda e vleres se mbetur, e përcaktuar në Ligjin nr. 8438 date 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" te ndryshuar.

Normat vjetore te amortizimit te aplikuara jane si më poshtë vijon:

| Pershkrimi | Norma vjetore | Metoda |
|---|---|---|
| Mjet transporti | 20% | Me vlere e mbetur |
| Pajisje informatike | 25% | Me vlere e mbetur |
| Mobilje e orendi | 20% | Me vlere e mbetur |

**Parapagime , shpenzime te shtyra**

Aktivet e njohura si Parapagime dhe shpenzime te shtyra paraqiten ne pasqyrat financiare me Vleren nominale te shumes se parapaguar.

**Shpenzime te konstatuara dhe te ardhura te shtyra**

Detyrimet per shpenzime te konstatuara paraqiten me Vleren nominale te shumes per tu paguar, ndersa detyrimet per te ardhurat e shtyra paraqiten ne pasqyrat financiare me kosto te amortizuar.

**Kapitali**

Kapitali i shoqerise eshte perbehet nga kuotat e kapitalit, te cilat jane njohur me vleren nominale, sikurse percaktohet ne statutin e shoqerise.

**Te ardhura te tjera dhe shpenzime financiare**

Te ardhurat e tjera permbledhin te ardhurat nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse, te ardhurat nga qirate, fitimet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale, si dhe fitimet nga kembimet valutore, si detyrime atehere kur perdoret Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huate, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet e aktiveve financiare.

**Tatimi mbi të ardhurat**

Shpenzimi (e ardhura) tatimor është shuma totale që i zbritet (shtohet) fitimit (humbjes) kontabël për përcaktimin e fitimit ose humbjes neto të periudhës kontabël, dhe përbëhet nga shpenzimi (e ardhura) tatimor aktual dhe shpenzimi (e ardhura) tatimor i shtyrë.

Tatimi aktual është shuma e tatimit mbi fitimin, e pagueshme (e zbritshme) mbi fitimin (humbjen) e tatueshëm të periudhës kontabël aktuale. Tatim fitimi eshte llogaritur ne perputhje me kerkesat e ligjit nr. 8438 date 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" te ndryshuar. Tatim fitimi eshte llogaritur ne masen 15% te te ardhurave te tatueshme.

Tatimi i shtyrë është tatimi i pagueshëm (i zbritshëm) në periudhat e ardhshme, zakonisht si rezultat i realizimit të aktiveve ose shlyerjes së detyrimeve nga njësia ekonomike me vlerën e tyre aktuale kontabël, dhe [illegible] i mbartjes së humbjeve tatimore dhe i tatimeve të zbritshme.

**Transaksionet ne valute te huaj**

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit.
Fitimet dhe humbjet qe rezultojne nga kryerja e transaksioneve ne monedhe te huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fund-vitit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.
Kurset e kembimit te perdorura per vleresimin e gjendjeve ne valute me date 31.12.2015 dhe 31.12.2014 jane:

| Monedha | 31 DHJETOR 2015 | 31 DHJETOR 2014 |
|---|---|---|
| EUR | 137.28 | 140.14 |
| USD | 125.79 | 115.23 |

**III. SHENIME SHPJEGUESE**

**1. Aktivet monetare**

| **Likujditete dhe vlera arke te tjera** | | |
|---|---|---|
| **Llogari ne banke** | **31.12.2015** | **31.12.2014** |
| Llogari rrjedhese ne LEK | 176,999,329 | 81,520,420 |
| Llogari rrjedhese ne EUR | 68,437,078 | 25,342,178 |
| Llogari rrjedhese ne USD | 2,087,451 | 32,668,368 |
| **Total mjete monetare** | **247,523,858** | **139,530,966** |

Vlera e mesiperme perfaqeson totalisht vleren e likuiditeteve me date 31.12.2015, gjendje ne llogarite qe shoqeria ka prane bankave te nivelit te dyte ne leke dhe valute. Gjendja e likuiditeteve (ne banke) e paraqitur në bilanc rakordon me shumën e ekstrakteve të bankes.

| **2. Te drejta te arketueshme nga njësitë ekonomike brenda grupit** | **31.12.2015** | **31.12.2014** |
|---|---|---|
| ITD Shpk | 22,000,000 | 0 |
| ITD Prishtine Shpk | 5,632,527 | 0 |
| TOTAL | **27,632,527** | **0** |

| **3. Të drejta të tjera** | **31.12.2015** | **31.12.2014** |
|---|---|---|
| Dega sigurimeve shoqerore | 0 | 3,391 |
| Shteti -Tatim Fitimi | 2,998,936 | 3,557,921 |
| TOTAL | **2,998,936** | **3,561,312** |

